

V E N D I M

Nr. 21 Datë 14.02. 2008

Për


Përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tarifore për periudhën 1 Mars 2008 – 28 Shkurt 2009

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, gërma b), 9, 26, pika 1, 27, dhe 28, të Ligjit 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, Vendimeve të Bordit të Komisionerëve Nr.28 datë 24.06.2005, Nr.29 datë 24.06.2005, Nr.30 datë 24.06.2005, përkatësisht “Metodologjitë e llogaritjes së tarifave për kompaninë publike të gjenerimit, të llogaritjes së tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike, dhe të llogaritjes së tarifave të shitjes tek klientët tariforë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 14.02.2008, pasi shqyrtoi dhe analizoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria KESH sh.a, për miratimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tarifore,

Vendosi

1. Miratimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tarifore për periudhën 1 Mars 2008 – 28 Shkurt 2009, sipas tabelës bashkelidhur këtij vendimi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s:

Për

**V E N D I M I N
Nr. 21 Datë 14.02. 2008**

Për

Përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tarifore për periudhën 1 Mars 2008 – 28 Shkurt 2009

Anëtarët e Bordit	Votimi	
	Pro	Kundër
1. Bujar Nepravishta	_____	_____
2. Entela Shehaj	_____	_____
3. Ardian Haci	_____	_____